

## Autoriteti Bankar dhe I Pagesave te Kosoves

Në pajtim me autoritetin q i'u është dhënë sipas Nenint 17.b të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24 të datës 1 Tetor 2001 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës si dhe Nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi Licensimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit,

Më qëllim të ekzekutimit të Nenit 26 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Udhëheqës i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars 2002 adoptoi siq vijon:

### **Rregulli 7 mbi Ndryshimin e Rregullit mbi Standardet e Kontabilitetit dhe Kërkesat për mbajtjen e shënimeve për Kompanitë e Sigurimit dhe Ndërmjetësuesit e Sigurimit e datës 18 Tetor 2001**

#### **Neni 1**

##### **1. Shtrirja e Rregullit**

Ky rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licensuar nga BPK-ja.

##### **2. Aspekti Ligjor**

Rregullorja e sigurimit të Kosovës specifikon se kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të përgatisin raportet e tyre financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në mënyrë specifike përfshijnë kërkesën për kontabilitetin e përlllogaritjes.

##### **3. Standardet e Kontabilitetit për Kompani të Sigurimit**

Njëra ndër veqoritë më të veqanta për kontabilitetin e sigurimit për kompani të sigurimit është nevoja e vendosjes së rezervave teknike. Rezervat teknike veqanërisht përfshijnë rezervat për permitë e perealizuara (pafituara) dhe

rezervat për dëmet: dëmet e papaguara si dhe dëmet e ndodhura por të paraportuara.

Kompanitë e sigurimit duhet të themelojnë rezervën për premi të porealizuara (pafituara) për të marrë parasyshë faktin që mbajtësit e polises shpesh paguajnë premi në avans. Sipas parimeve të kontabilitetit të përlogaritjes shumat e paguara në avans për marrjen e një sherbimi duhet të raportohen si rezerva për premitë e porealizuara në fund të një periudhë të kontabilitetit kur mbajtësi i polisës akoma do të kënaqet me beneficinin e asaj mbulese.

Kompanitë e sigurimit gjithashtu duhet të themelojnë rezervë për dëme. Kjo përfaqëson parashikimin më të mirë të kompanisë për shumën e dëmeve që do të duhet të paguaj. Dëmet zakonisht ndahen në ato të cilat janë raportuar por që ende nuk janë paguar dhe ato të cilat kanë ndodhur por ende nuk janë raportuar (dëmet IBNR). Të gjitha parashikimet e dëmeve duhet të jenë plotësisht të arsyeshme dhe të bazuara në evidencën statistikore siq përgatitet dhe shqyrtohet nga një aktuar apo nga një ekspert i rezervave për dëmet, siq aprovet nga BPK-ja.

Përvoja në Kosovë është e kufizuar dhe në një shkallë të zhvillimit. BPK-ja do të themelojë një raport të përhershëm të humbjeve të ndodhura si dhe një përqindje të përhershme të humbjeve të ndodhura por të paraportuara. Raportet Financiare do të regjistrojnë këto shuma të vendosura apo shumat aktuale cilado qofshin më të mëdha.

#### **4. Kërkesat për shënime për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit**

Të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licensuar nga BPK-ja duhet të mbajnë shënime të plota dhe të sakta në zyrat e tyre për të lehtësuar ekzaminimet efikase të BPK-së. Kjo kërkesë aplikohet për të gjitha shënimet e tanishme si dhe ato për pesë vitet financiare të mëparshme. Shënime të caktuara do të klasifikohen si shënime të përhershme dhe do të kërkohen të jenë në dispozicion për inspektim në cdo kohë.

Kërkesa për të mbajtur shënime të plota dhe të sakta përfshinë por nuk kufizohet në organogramin dhe dispozitat e kompanisë apo dokumentacion ekuivalent, regjistrin e premive si dhe raportet mujore të premive, regjistrin e dëmeve dhe raportet mujore të dëmeve, librin e përgjithshëm të llogarive, librin e premive, librin e dëmeve, marrëveshjet e risigurimit (vetëm kompanitë e sigurimit), procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve, listën e azhurnuar të agjentëve të autorizuar (vetëm Kompanitë e sigurimit), të gjitha raportet financiare dhe raportet dhe programet ndihmëse, lista e të gjithë drejtorëve dhe detajet kontaktuese të tyre, si dhe lista e të gjithë aksionarëve dhe numri i aksioneve të secilit aksionar sikurse edhe detajet kontaktuese të tyre. Referencat

për aksionarë dhe drejtorë nuk aplikohen për ndërmjetësues sigurimi të painkorporuar.

Revizoret e brendshëm dhe të jashtëm si dhe ekzaminuesit e BPK-së duhet të jenë të gatshëm dhe në gjendje të gjurmojnë dhe barazojnë shifrat e raporteve financiare të prodhuara nga kompania e sigurimit e licensuar dhe ndërmjetësuesi I sigurimit së bashku me të gjitha informata përkrahëse.

Dështimi për t'iu përmabjtur dispozitave të këtij rregulli mund të bëjë që kompania apo ndërmjetësuesi dhe drejtorët dhe menaxherët të i'u nënshtrohen sanksioneve të përshkruara në Rregulloren e Sigurimit. Referencat e drejtorëve nuk aplikohen për ndërmjetësuesit e painkorporuar të sigurimit.

## **5. Regjistri i Premive**

Të gjitha Kompanitë e Sigurimit dhe Ndërmjetësuesit e Sigurimit duhet të mbajnë regjistrin e premive në të cilën përfshihen të gjitha premitë e shkruara, të realizuara, kërkesat dhe të mbledhura. Regjistri I premisë duhet të paraqesë për secilën polisë individuale, llojin e polisës së sigurimit të lëshuar, shuma maksimale e mbulesës së ofruar, data e përfundimit dhe data e pagesës aktuale të premive, emri i mbajtësit të polisës dhe përfituesit (nëse aplikohet) si dhe ndërmjetësuesin e sigurimit të përfshirë (nëse aplikohet).

## **6. Raportet e Premive**

Të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të hartojnë raportin mujor të premive. Raporti do të ofrojë detaje mbi numrin e polisave të reja të lëshuara, totalin e premive të shkruara, të realizuara, kërkesat (për t'u marrë) dhe të mbledhura. Premitë që janë për t'u marrë (kërkesat) dhe premitë e vonuara duhet të transferohen në regjistrin mujor të ardhshëm të premive.

## **7. Regjistri i Dëmeve**

Të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit gjithashtu duhet të përgatisin regjistrin e dëmeve në të cilin raportohen të gjitha dëmet. Regjistri i dëmeve duhet të shënoj për secilin dëm individual, numrin e dëmit, data e pranimit të dëmit, emrin e mbajtësit të polisës dhe përfituesit (nëse aplikohet) si dhe ndërmjetësuesin e përfshirë (nëse aplikohet).

## **8. Raporti i dëmeve**

Të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet gjithashtu të mbajnë raportin mujor të dëmeve. Raporti do të ofrojë detajet mbi numrin total të dëmeve të pranuar, dëmet e paguara, dëmet e refuzuara dhe dëmet e pezulluara sipas llojit të dëmit. Dëmet e pezulluara në cdo fund muaj duhet të transferohen në regjistrin e ardhshëm mujor për dëme.

## **9. Llibrat e Kontabilitetit**

Të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet gjithashtu të prodhojnë librin e premive, librin e dëmeve si dhe sikur zakonisht librin e përgjithshëm të llogarive.

Këta libra duhet të jenë të barazueshëm me raportet mujore të premive dhe dëmeve sikurse edhe me regjistrat e nënvizuar të premive dhe dëmeve.

## **10. Udhëzimet dhe kërkesat e përgjithshme**

Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit do të mbajnë të gjitha shënimet e tyre në formë elektronike përderisa ato janë lehtë për të i'u qasur për revizorët e brendshëm dhe të jashtëm si dhe për ekzaminuesit e BPK-së. Shënimet elektronike duhet të ruhen në baza ditore. Kopjet e të gjitha shënimeve elektronike duhet të mbahen në një vend të sigurtë të jashtëm.

Të dyja, shënimet e jashtme dhe të brendshme, qoftë në kopje letre apo në formë elektronike duhet të mbahen të sigurt nga zjarri, vjedhja, dëmtimi nga uji, sabotimi dhe nga rreziqe tjera shkatërruese.

Kompanitë e sigurimit do të dorëzojnë dosjen elektronike në BPK cdo muaj që përfshinë Bilancin e Gjendjes, Bilancin e Suksesit, Raportin e Investimeve, Regjistrin e Premive dhe Regjistrin e Dëmeve në formatin e përshkruar nga BPK-ja.

### **Neni 2 Hyrja në Fuqi**

Ky rregull i tanishëm do të hyjë në fuqi me 1 Prill 2002

David Weatherman  
Ushtrues i detyrës së Drejtorit Menaxhues